Projekti Zhvillimor për Ujërat e Zeza në Mitrovicë

Lokacioni:
Kosova

Numri i Projektit:
50458

Sektori i aktivitetit:
Infrastruktura komunale dhe mjedisore

Lloji i njoftimit:
Publike

Kategoria mjedisore:
B

Datat e synuara të dorëzimit:
27 Shku 2019

Statusi:
Koncepti i shqyrtuar

PSD e shpallur ne gjuhen angleze:
25 Shta 2018

Përshkrimi i Projektit

Ofrimi i një kredie sovrane deri në 18 milionë euro për Qeverinë e Kosovës, që do t'i bartet tutje kompanisë rajonale të ujësjellësit Mitrovica ("KRUM" ose "Kompania") për të financuar një pjesë të zgjerimit dhe rehabilitimit të rrjetit të grumbullimit të ujërave të zeza dhe ndërtimit të impiantit të ri të trajtimit të ujërave të zeza ("ITUZ"). Kredia do të përmbushë nevojat kritike të trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Mitrovicës, si dhe komunat fqinje të lidhura, si dhe do të jetë e dobishme për rreth 116,000 banorë. Projekti do të bashkëfinancohet me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI).

Objektivat e Projektit

Financimi do t'i mundësojë Kompanisë që të rehabilitojë, renovojë e zgjerojë rrjetin e ujërave të zeza, si dhe të ndërtojë një ITUZ të ri të centralizuar, për të grumbulluar e trajtuar ujërat e zeza në përputhje me standardet përkatëse mjedisore të BE-së.

Implementimi i projektit do të sjellë dobi të konsiderueshme mjedisore për burimet lokale të ujit të freskët, duke zvogëluar në masë të madhe vëllimet e ujërave të zeza të patrajtuara, si dhe ngarkesat përkatëse të ndotjes, të cilat shkarkohen drejtpërdrejt në lumë. Projekti pritet të rrisë numrin e njerëzve të kyçur në rrjetin e kanalizimeve në zonën e shërbimit të Kompanisë.

Ndikimi kalimtar

Mirë

Burimet e ndikimit kalimtar janë:

1) Gjelbër. Projekti pritet të rrisë numrin e kyçjeve në rrjetin e ujërave të zeza, si dhe të arrijë përputhjen me standardet mjedisore të BE-së në trajtimin e ujërave të zeza.

Projekti mbështet plotësisht qasjen e Agjendës së Bankës për Tranzicionin drejt Ekonomive të Gjelbra, duke financuar investime që sjellin dobi mjedisore dhe zbusin efektet e ndryshimeve klimatike.

2) Mirë-qeverisje. Banka do të mobilizojë ndihmën teknike për të përmirësuar Kontratat e Shërbimit Publik (KSHP) ndërmjet Kompanisë dhe komunave që ajo shërben. Projekti do të mbështesë edhe përmirësimet e qeverisjes korporative përmes Programit të Përmirësimit Financiar dhe Operativ (FOPIP) me qëllim të ngritjes së performancës menaxheriale.

Informatat për Klientin

SH.A. Mitrovica

KRUM është shoqëri aksionare, në pronësi të plotë të Qeverisë. Kompania menaxhon dhe operon me sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza në shtatë komuna (Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë e Jugut, Skënderaj, Vushtrri dhe Zveçan), ku shërbehen afro 30,000 ekonomi familjare, duke mbuluar një zonë shërbimi me popullsi prej 185,000 banorësh.

Përmbledhja e Financimit nga BERZH

18,000,000.00 Euro

Kredi sovrane për Qeverinë e Kosovës, që i bartet tutje KRUM.

Kostoja totale e Projektit

37,200,000.00 Euro

Përmbledhje mjedisore dhe sociale

Projekti kategorizohet si B në Politikën Mjedisore dhe Sociale 2014. Projekti pritet të ofrojë dobi të konsiderueshme mjedisore dhe shëndetësore krahasuar me gjendjen ekzistuese, duke përmirësuar shërbimet e menaxhimit të ujërave të zeza në Komunën e Mitrovicës, përmes zhvillimit të grumbullimit të ujërave të zeza dhe impiantit të ri të trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ). Çdo lloj ndikimi negativ pritet të lokalizohet përkohësisht, si dhe të parandalohet apo zbutet duke i respektuar praktikat e mira ndërtimore.

Faza e studimit të hollësishëm mjedisor dhe social (ESDD) do të zbatohet nga konsulentë të jashtëm, si pjesë e Studimit të Fizibilitetit. ITUZ-i do të ndërtohet në 2 faza: Faza e parë që shërben 95,000 popullatë ekuivalente (p.e.) si dhe që përbëhet nga trajtimi primar dhe sekondar me tretje të llucës anaerobike.

Faza e dytë do të zgjerojë ITUZ-in deri në kapacitetin e plotë të dizajnimit me rreth 116,000 p.e., si dhe të sigurojë tretjen plotësuese të nutrientëve, për të përmbushur standardet e pritura të sipërfaqeve të ndjeshme të rrjedhës ujore pranuese, deri në përmbushje të kritereve përkatëse shtetërore dhe të BE-së. Faza ESDD do të vlerësojë mes tjerash edhe nëse analiza përkatëse e lokacioneve alternative për ITUZ dhe angazhimi përkatës i palëve me interes janë përmbushur si pjesë e procesit të marrjes së lejeve, si dhe çfarë masash plotësuese do të jenë të nevojshme për të plotësuar kriteret e BERZH-it. Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social (ESAP), Plani i angazhimit të palëve të interesit (SEP), do të hartohen, si dhe do të prezantohet një përmbledhje jo-teknike (NTS) e Projektit.

Faza e studimit të hollësishëm është aktualisht në vazhdim, ndërsa ky Dokument do të freskohet pasi të kemi në dispozicion gjetjet e ESDD-së.

Bashkëpunimi teknik

Para nënshkrimit

- TC1 - Analiza e mangësive në Studimin e Fizibilitetit, bashkë me studimin e hollësishëm mjedisor dhe social. Kostoja e kësaj detyre është 58,500 Euro, bashkëfinancuar me BEI-në.

Pas nënshkrimit

- TC2 - Ndihma në Prokurim dhe Implementim për NJIP-në, duke përfshirë administrimin e prokurimit, mbikëqyrjes dhe kontratës. Kostoja e kësaj detyre vlerësohet të jetë afro 350,000 Euro, që do të financohet nga Korniza Investuese e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor - WBIF.

- TC3 - Programi i Përmirësimit të Performancës Financiare dhe Operative, duke përfshirë rishikimin e PSC-së dhe Planit të Menaxhimit të Aseteve

Infrastrukturore. Kostoja e kësaj detyre është 300,500 Euro, që financohet nga një donatorë ndërkombëtar ose Fondi i Posaçëm i Aksionarëve të BERZH-it.

Informata kontaktimi të Kompanisë:

Sami Miftari
sami.miftari@kru-mitrovica.com
+383 28 520304
http://www.mzhe-ks.net/npmnp/?page=1,83
Bislim Bajgora pn. 40000 Mitrovicë

Mundësitë për biznes

Për mundësitë për biznes ose prokurimet, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për projektet e sektorit publik, vizitoni Prokurimet e BERZH-it.: Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Informacione të përgjithshme

Informacione rreth projekteve të BERZH-it që nuk lidhen me prokurimet:
Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe perceptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të saj. Ju lutemi vizitoni faqen e mëposhtme të Politikës së Informimit Publik për të zbuluar se si të kërkoni Raportin e Bordit për Sektorin Publik.
Teksti i PIP-së

Mekanizmi i Ankimimit të Projektit (MAP)

Mekanizmi i Ankimimit të Projektit (MAP) është mekanizmi i llogaridhënies së BERZH-it. Ai mundëson shqyrtimin e pavarur të ankesave të individëve dhe organizatave lidhur me projektet e financuara nga BERZH-i, të cilat hamendësohet të kenë shkaktuar, apo të kenë gjasa të shkaktojnë, dëme mjedisore dhe sociale.

Ju lutemi vizitoni faqen e Mekanizmit të Ankimimit të Projektit për më tepër informacion rreth mënyrës së depozitimit të një ankese. Përgjegjësi i MAP-it (pcm@ebrd.com) është në dispozicionin tuaj për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni lidhur me depozitimin e një ankese dhe kriteret për regjistrimin dhe përputhshmërinë, në pajtim me rregullat e procedurës së MAP-it.